



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-08-0299

Paditësja:

L S – nga Beogradi, Serbi, përfaqësuar nga
Av. D L nga G.

Kundër

E Paditur:

N.SH "Pasuria Bujqësore" Ferizaj të cilën e përfaqëson Agjencia
Kosovare e Privatizimit – Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe, Hajrie Shala, gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 05 janar 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- I. Padia e paditëses hedhet poshtë si e palejueshme.**
- II. Paditësja e ka paguara taksen gjyqësor dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 10 dhjetor 2008, paditësja parashtroj në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (tutje DHPGJS), padi kundër Agjencia Kosovare të Mirëbesimit. Në padi paditësja ka theksuar se në Gjykatën Komunale në Ferizaj është duke u zhvilluar procedurë për anulimin e kontratës së dhurimit të tokës me sipërfaqe prej 6.31,00 ha. Ka shtuar se për këtë çështje juridike ishte marrë aktgjykim në shkallën e parë sipas lëndës C.nr.1476/92 të datës 08 prill 1998, mirëpo aktgjykimi në fjalë ishte prishur me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1050/98 të dt.25 janar 1999 dhe çështja ishte kthyer në rivendosje. Paditësja është trashëgimtare e të ndjerit J S dhe ka interes juridik për ta anuluar kontratën e dhuratës nr.7063/23 të dt.23.09.1953 të cilën e

kishte lidhur trashëgimlënësi i saj. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses dhe ta anuloj kontratën mbi dhuratën e lartcekur.

Me 19 tetor 2017, DHPGJS përmes urdhrorit ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj që të sqarohet se a ka aktgjykim të plotfuqishëm në çështjen juridike të paditëses.

Me 08 nëntor 2017, përmes parashtresës Gjykata Themelore në Ferizaj ka njoftuar DHPGJS, se si sipas verifikimit që kanë bërë në arkivin e gjykatës dhe në program lënda në fjalë është e pa kryer dhe ka marrë numër të ri C.nr.69/99.

Me 10 tetor 2018 paditësja përmes parashtresës i ka sqaruar gjykatës se paditësja për të njëjtën çështje juridike si trashëgimtare e Jugoslav Saviq është duke zhvilluar procedurë në Gjykatën Themelore në Ferizaj sipas lëndës C.nr.69/99, mirëpo tani kjo e fundit me aktvendimin C.nr.215/07 lëndën e ka transferuar në DHPGJS. Përmes kësaj parashtrese paditësja si të paditur e ka paraqitur N.SH "Pasuria Bujqësore" Ferizaj të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit. Paditësi ka bashkangjitur edhe Aktvendimin e trashëgimisë O.nr.17/95.

Me 01 nëntor 2022, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër padisë, ka propozuar që kërkesa padia e paditëses të refuzohet si e pabazuar, me arsyetim se paditësja nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme më të cilën do të bënte të besueshëm kërkesëpadinë e saj, madje e njëjta nuk ka bashkangjitur as kontratën mbi dhuratën, anulimin e së cilës e kërkon. Ka shtuar se dhuratëdhënësi me vullnetin e tij të lirë i kishte falur token ndërmarrjes Shoqërore. Nga pohimet në padi nuk mund të kuptohet se a kemi të bëjmë me anulimin e kontratës absolutisht nule apo të rrëzueshme. Po ashtu nga pohimet në padi nuk jepen shpjegime se paraardhësi i paditëses kontratën mbi dhuratën ta këtë lidhur nën presion, kërcenim, mashtrim apo lajthim. E drejta për anulimin e kontratës sipas ligjit mund të kërkohej në afat për 1 vit nga dita e njoftimit për arsyen e rrëzueshmerisë, respektivisht nga momenti i ushtrimit të presionit e më së largu e drejta për anulimin e kontratës pushon me kalimin e afatit 5 vjeçar, nga dita e lidhjes së kontratës. E paditura i është referuar edhe nenit 7 të LPK-së lidhur me procedurën e të provuarit nga paditësja.

Me 07 dhjetor 2022, gjykata ka mbajtur një seancë dëgjimore. Në seancë kolegji është informuara më saktësisht nga përfaqësuesi i paditëses se paditësja është duke zhvilluar procedurë për çështjen e njëjtë juridike në Gjykatën Themelore në Ferizaj sipas lëndës C.nr.1476/92 dhe se për këtë nuk ka mundur të sigurojë provat, meqë në atë lëndë gjenden provat e kompletuara dhe ka kërkuar nga gjykata që të sigurojë ato në rrugë gjyqësore.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës.

Arsyet ligjore:

Padia e paditëses hedhet poshtë si e palejueshme.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka zbatuar dispozita e Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Neni 391 pika c) e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore thotë:

Gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca);

Po ashtu nenin 262, para 3 dhe 4 i LPK-së thotë:

262.3 “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të inicohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”

262.4 “Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.”

Gjykata pas pohimit nga paditësja se për të njëjtën çështje juridike ekziston edhe një lëndë tjetër në pritje, ka kërkuar informata nga zyra e regjistrimit të DHPGJS dhe ka shikuar dosjen lëndës ashtu që ka vërejtur se paditësja si trashëgimtare e të ndjerit Jugoslav Saviq kishte në procedim e sipër edhe një procedurë gjyqësore për të njëjtën kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, që nga viti 1992. Rasti në fjalë është identik me rastin në gjykim dhe ka të bëjë me anulimin e kontratës së dhuratës nr.7063/23 dt. 23 09.1953. Kolegji po ashtu verën Gjykata Komunale e Ferizajt me Aktvendimin C.nr.215/07, të dt. 08 gusht 2012 e kishte shpallur veten jo kompetent për gjykimin e çështjes dhe lëndën e kishte dërguar për gjykim në DHPGJS dhe tani kjo lëndë mban numrin si C-III-12-2022.

Gjykata konstaton se paditësja si trashëgimtare e J S edhe pse ishte duke zhvilluar procedurë në Gjykatë dhe lënda është ende aktive, ajo përsëri kishte paraqitur kërkesëpadi të njëjtë në DHPGJS dhe lënda ishte regjistruara si SCC-08-0299. Po ashtu vërehet se lënda C-III-12-2022, është me e avancuar dhe me e kompletuar me prova materiale.

Siç u arsyetua më lartë meqë për të njëjtën çështje të ngritur nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta, padia e paditësit konform nenit 391, pika c) hedhet poshtë si e palejueshme.

Andaj nga arsyet si me lart Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.1 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, paditësja e ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hajrie Shala, Gjyqtare